- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2017, 2018, 2019), duhet të ketë një vlerë jo më të ulët **se fondi limit që prokurohet**. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të (2017, 2018, 2019), të paraqitura pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet e qeverisjes vendore për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, 2020, në vendet ku ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës/ve. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa “a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. 2.3.1 1. Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e realizimit të leshuar nga institucioni.
- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të shenohen datat, dhe të jete i specifikuar shërbimi i kryer.

2.3.2 Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri mesatar i punonjësve të siguar duhet të jetë **jo më pak se 7 (SHTATE)** punonjës për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së tenderit: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (*drejtues teknik*), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj, , **diplomat , kontratë individuale pune të noterizuar dhe licencën e mbikqyresit të tyre.** Operatori ekonomik duhet të paraqesin të dhëna të plota të personit të kontaktit, të stafit drejtues teknik, të cilet do të jenë përgjegjës për kryerjen e këtij shërbimi dhe ndjekjen e tij në terren.

2.3.4 Drejtuesit teknikë të kërkuar më poshtë duhet të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqëruara të siguar për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së tenderit :

- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
 - **1 (një) Inxhinier Gjeodet**
 - **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
 - **1 (një) Inxhinier Elektrik**
 - **1 (një) Inxhinier Mekanik**
 - **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
-
- **1 (një) punonjës I pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për

sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë

•

2.3.5 Liçenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikeqyrje ku të përfshihen kategorite:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 Punime gjurmimi në tokë
- NP-2 Ndërtime civile dhe industrial
- NP-7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-18 Punime topogjeodezike

2.3.6 Kandidati/ofertuesi te paraqese certifikatat te vlefshme:

- Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate ISO 9001-2015 te vlefshme ose ekuivalente per sistem menaxherial te cilesise.
- Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate ISO 14001-2015 te vlefshme ose ekuivalente per sistem menaxherial te mjedisit.
- Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate ISO 18001-2007 ose ISO 45001-2018 te vlefshme ose ekuivalente per sistem menaxherial te shendetit dhe sigurise ne pune.
- Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate ISO 39001-2012 te vlefshme ose ekuivalente per sistemi i menaxhimit të sigurise ne trafikun rrugor.
- Operatori Ekonomik duhet te zoteroje dhe te paraqese nje çertifikate PASS 99-2012 te vlefshme ose ekuivalente per sistem te menaxhimit te integruar.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)

2.3.7 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira instrumentat topografike si me poshte:

I. Pajisje GPS 2 (dy) copë,

Në lidhje me sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë Qiraje të noterizuar (*original ose fotokopje e noterizuar*).

2.3.10 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin **analizat e çmimeve** mbi tarifën/at profesionale të ofruara, perlllogaritjen e kostove dhe shpenzimeve per realizimin e shërbimit.

Shënim: Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim*", si dhe në mbështetje të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me nr.5585 Prot. "*Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016*" "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim*", si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me nr.6559 prot. te APP.

Ofertat me vlere me te ulet se sa vlere minimale dhe me vlere me te larte se vlere maksimale, te llogaritura sipas VKM nr.354, dt.11.05.2016, "*Per miratimin e manualit te tarifave per shërbime ne planifikim terrritori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim*", **do te skualifikohen.**

Ne rast se oferta paraqitet nga bashkim operatoresh ekonomike, Shtojca nr.7 e DST (*Kriteret e vecanta te kualifikimit*) duhet te plotesohet ne perputhje me nenin 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*".

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: **Bashkalidhur DST në SPE.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **sipas Termave te References.**

Mbikqyresi i punimeve duhet të permbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në mbështetje të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 "PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDERTIMIT" të ndryshuar, Udhezimit të KM Nr.3 date 15.02.2001 për "Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndertimit" i ndryshuar me Udhezimin e KM Nr.4 dt 17.05.2001, Udhezimin e KM, Nr.7 date 21.11.2001, Udhezimin e KM Nr.1 dt. 22.02.2005 dhe Udhezimin Nr.1 të KM date 16.06.2011 dhe të Udhezimit të KM Nr. 2, date 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndertimit".

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Mbikëqyrje e punimeve për objektin “UJËSJELLËSI, I FSHATIT DUHANAS , FSHATIT LAPARDHA 1, OTLLAK DHE ORIZAJ, BASHKIA BERAT”**

Afatet e ekzekutimit: **6 (gjashtë) muaj** *(Duke filluar nga nënshkrimi i kontratës deri në përfundimin e plotë të punimeve të zbatimit për objektin “UJËSJELLËSI, I FSHATIT DUHANAS , FSHATIT LAPARDHA 1, OTLLAK DHE ORIZAJ, BASHKIA BERAT”)*

Afati i realizimit të mbikëqyrjes së punimeve do të jetë i njëjti me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndertimore e cila do të zbatojë punimet.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti: ***“Mbikëqyrje e punimeve për objektin “UJËSJELLËSI, I FSHATIT DUHANAS , FSHATIT LAPARDHA I, OTLLAK DHE ORIZAJ, BASHKIA BERAT”***, bazuar ne V.K.M. nr.354, date 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*, bën pjese ne objektet që i përkasin kategorive **”Vepra Inxhinierike”**.

Vlera e fondit limit te zbatimit te punimeve te objektit per te cilin do te kryhet mbikëqyrja eshte **4 022 928.00** (katër milion e njezet e dy mije e nenteqind e njezet e tete) **lekë pa TVSH**.

1. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objektivi kryesor i Mbikëqyrësit

1.1 Mbikëqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

2.Detyrat, përgjegjësite dhe të drejtat e Mbikqyrësit

Të përgjithshme

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes se kontrates duhet:

- Të mbikqyrë kontraten e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi.

- Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilesinë e punimeve, si dhe zbatimin e VNM në bazë të standardeve të përcaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt.22.02.2005, UKM Nr. 2, date 13.05.2005).
- Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.

2.2 Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.

2.3 Mbikqyrësi vë në dijeni Autoritetin Kontraktor për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh Sipërmarrësi (Zbatuesi i Punimeve) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.

2.4 Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse vendore, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislacionin në fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998).

3. Detyrat e mbikqyrësit

3.1 Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës të liçensave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe gati për të filluar punimet.
- Të njihet me hollësi me kontratën e zbatimit të punimeve dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimi i objektit:
- Data e marrjes së lejes së ndërtimit:
- Investitori:
- Projektuesi:
- Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik:
- Mbikqyrësi i Punimeve:
- Afati i ndërtimit të objektit:
- Vlera e objektit:

3.2 Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të

tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenereve, etj.

- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:
 - Stafi i Sipërmarrësit
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit
 - Pikat e marrjes së lëndëve të para inerte
 - Zonat e ngritjes së kantjerit
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e Sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të konstatojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe ti propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.
- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhene udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratës.
- Të kontrollojë në menyrë korekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbajë procesverbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
- Në çdo fund dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmosë atë.
- Të kontrollojë librezën e masave, e cila vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.
- Gjatë zbatimit të projektit, i jep udhëzime me shkrim Sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme dhe Sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit, ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me udhëzimet dhe urdhërat e marra.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një relacion të plote teknik, shoqëruar me skicat përkatëse ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt, gjatë zbatimit të punimeve, do të bëhet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
- Në çdo fund muaji, Mbikqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport

mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e progresit të punimeve dhe të pagesave të kryera, realizimi i punimeve në vlerë dhe përqindje, afati kohor, realizimi i financimit.

- Korrespondenca ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

3.3 Raporti Mujor do të përmbajë lëndën e mëposhtme:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
- Të përgjithshme
- Qëllimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndërtimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi
- Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve
- Stafi aktual
- Kohëqëndrimi në objekt për secilin pjesëtar të stafit mbikqyrës
- Raportimi
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes
- Përshkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe të dhëna për objektin specifik
- Organizimi i Sipërmarrësit
- Sipërmarrësi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Kohëqëndrimi në objekt
- Progresi Mujor
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografi të proçeseve të punimeve të kryera
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm
- Grafiku i ecurisë së punimeve
- Punimet e Aprovuara dhe të kryera
- Punimet e Kryera por të pa aprovuara
- Volumet Progressive të Punimeve Mujore
- Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike,
- Libreza e Masave
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhëra, Udhëzime, Njoftime
- Ndryshime në Projekt - Preventiv nëse ka (të aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë , teknike , sociale

- Konkluzione

4. Përgjegjësitë e Mbikqyrësit

- a. Në fillim të punimeve Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vendimin e sheshit të ndërtimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
 - Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
 - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
 - Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
 - Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
 - Për realizimin me korrekthei të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarësit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
 - Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyrësit. Sipërmarësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
 - Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Në rast se gjatë zbatimit të kontratës ndodh ndërrimi i Mbikqyrësit të punimeve, për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon Mbikqyrësi, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me procesverbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

5. Te drejtat e Mbikqyrësit

5.1 Mbikqyrësi ka të drejtë:

- Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të specialisteve/punëtorëve të sipërmarësit në rast mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, specialist/punëtor, etj, nëq këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar

punimet dhe trafikun.

- Të kërkojë çertifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
- Të mos lejojë vendosjen në veper të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh normale dhe cilësore.
- Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme nqs ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga Mbikqyrësi i Punimeve këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
- Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën e duhur në raport me vëllimet e realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Siëermarrësit.
- Kur Mbikqyrësi i punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të Sipërmarrësit. Në rast të kundërt, Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyrësi i punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast, sipas fajit, Mbikqyrësi së bashku me Autoritetin Kontraktor dhe Sipermarresin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin ose jo të shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Kontraktor për gjendjen e tij. Në rast se Autoriteti Kontraktor ka verejtje e njofton Sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Për çdo ndryshim të mundshëm në objekt, Mbikqyrësi i punimeve vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

5.2 Në përfundim të punimeve Mbikqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve nga sipemarrësi dhe vërteton në procesverbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës.
- Sipas legjislacionit në fuqi dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

5.3 Ky dokumentacion duhet të përmbajë :

- Proçes-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proçes-verbalin për fillimin e punimeve.
- Kontratën e Sipërmarrjes
- Kontratën e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik të zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka zëra të rinj të punimeve, negocimin e tyre)
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit të punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik për punime të paparashikuara
- Dokumentacionin fotografik apo video për punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyrësi i Punimeve të shoqëruar me fotografi.
- Ditarin e objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga Mbikqyrësi i Punimeve.
- Librezën e masave.
- Shkresën e Mbikqyrësit të Punimeve për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi i Punimeve.
- Preventivin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi i Punimeve.
- Situacionin e fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyrësi
- Çertifikatat e cilësisë së materialeve
- Miratimin nga Mbikqyrësi të materialeve të përdorura
- Situacionet pjesore dhe situacioni përfundimtar
- Regjistrin e kontabilitetit
- Deklaratën teknike të Sipërmarrësit të firmosur nga Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipërmarrësit për përfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e përfundimit të punimeve të firmosur nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve.
- Relacionin përfundimtar të Mbikqyrësit të Punimeve.

- 5.4 I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyrësit të Punimeve. Ky dokumentacion përgatitet e dorëzohet në 5 (pese) kopje.
- 5.5 Një kopje origjinale e të gjithë dokumentacionit i vihet në dispozicion kolaudatorit ose grupit të kolaudimit.
- 5.6 Mbikqyrësi i punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos në aktin e kolaudimit. Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikqyrësi i punimeve mbështetur në vlerën e kontratës, situacionin përfundimtar dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur Sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetit Kontraktor.

6. Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes:

6.1 Kohëzgjatja e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet, përfshirë kolaudimin si dhe inspektimet gjatë periudhës 2 vjeçare të garancisë së difekteve kur kërkohet nga investitori.

6.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyrësit të Punimeve kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara .
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre .
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilesisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e duhur, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdhërojë Mbikqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **UJËSJELLËSI, I FSHATIT DUHANAS , FSHATIT LAPARDHA 1, OTLLAK DHE ORIZAJ, BASHKIA BERAT, sipas Projektit të zbatimit të punimeve bashkëlidhur DST.**

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR²

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

² Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit

Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

